



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 17 , Datë 11 / 1 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 113, datë 09.08.2017, e bërë nga A.L¹, kundër Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se është martuar në vitin 2016 dhe ka një fëmijë të vogël që jeton me të, pasi nëna e fëmijës është në proces divorci me bashkëshortin e parë. Që në vitin 2004 ka bërë kërkesë për strehim dhe është në pritje të përfitimit të strehimit. Rreth datës 02.08.2017 është paraqitur tek zyra e strehimit pranë bashkisë për të kërkuar strehim dhe gjatë takimit me Drejtorin, është konfliktuar me të dhe ka pasur fjalë fyese nga ana e Drejtorit. Ankuesi kërkon nga bashkia Korçë mbështetje me shtëpi.

Raca dhe gjendja shëndetësore² janë shkaqe për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën dhe gjendjen shëndetësore.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen

¹ Ankuesi i përket komunitetit Egjiptian të Bashkisë Korçë.

² A.L është i pajisur me Vërtetim KMCAP që plotëson kushtet për të përfituar PAK, Gr.2, pasi vuan nga sëmundja: Çrregullim depresiv rekurent, çrregullim personaliteti.

shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 820/1 prot, datë 22.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me ankesën e bërë nga A.L, për të përfutur strehim nga ana e bashkisë.

Me shkresën nr. 3814/1 Prot, datë 04.09.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Korçë, informon se: *“Bashkia Korçë, në mbështetje për mirërritjen e fëmijës së A.L, e ka rekomanduar si përfutues i një programi të veçantë të bashkisë për çerdhe pa pagesë si familje e komunitetit rom në nevojë si dhe strehim të përkohshëm në “Shtëpinë e Foshnjës” me afatin që vetë A.L do të ishte i interesuar, për marrjen e shërbimit të specializuar për fëmijën dhe strehimin deri në një moment më të përshtatshëm ekonomik dhe social të tij. Lidhur me strehimin e A.L, Bashkia Korçë, pas disa takimeve të zhvilluara i ka rekomanduar programin e “Bonusit të strehimit” deri në 50%, si i vetmi program në zbatim për momentin në Bashkinë Korçë, Kreu IV, neni 13 i ligjit 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” dhe subvencion deri në 100% me fonde të bashkisë, të qerasë së një ambienti banimi si person me nevoja të veçanta dhe anëtar i komunitetit rom. A.L ka ngritur pretendimin se ka kërkuar banesë me qera por asnjë nuk pranon ti ofrojë shtëpi me qera. Në këto rrethana, drejtori personalisht, ka ndërmjetësuar në Mborje, një fshat me kushte shumë të mira rreth një km larg qytetit të Korçës dhe ka gjetur dy hyrje pallati të cilat jepen me qera (të subvencionuar nga fondi i bashkisë) por dhe kjo është refuzuar nga A.L. Në lidhje me pretendimin që është regjistruar nga viti 2004 si i pastrehë, bashkia nuk disponon asnjë të dhënë ose kërkesë në regjistrat e zyrës së të pastrehëve dhe për këtë arsye kërkuam dhe informacion nga ZRPP, ku figuron që A.L ka privatizuar një banesë shtetërore të cilën e ka shitur dhe rrjedhimisht bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, neni 5/a si dhe në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” nuk mund të pranohet aplikimi i tij. Theksojmë se të gjitha mundësitë e ofruara më lart janë të vlefshme në çdo kohë, mjafton që A.L të konsiderojë një ose dy prej tyre”.*

Me shkresën, Kërkesë, datë 10.10.2017 drejtuar zyrës së Komisionerit, ankuesi A.L ka informuar për tërheqjen e ankesës, pasi kërkesa e tij për strehim ka marrë zgjidhje nga ana e bashkisë, të cilët i kanë ofruar banesë tek ish konvikti. Zgjidhja e çështjes së strehimit të A.L është bërë e njohur dhe nga specialistja e Komisionerit pranë zyrës Korçë, nëpërmjet emailit datë 29.09.2017 dhe datë 11.10.2017.

Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson se:

Programet sociale për strehimin e familjeve në zonat urbane rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit të Banorëve të Zonave Urbane” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Bazuar në nenin 1, pika 2, të këtij ligji, ku citohet se: “Ky ligj e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”, Bashkia Korçë, ka për detyrë të trajtojë çështjet e strehimit social.

Ligji nr. 9232, dt. 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, në nenin 24 të tij parashikon mundësinë e subvencionimit të qerasë. Ky nen, në pikën 2 të tij, parashikon se, familjet e komunitetit rom dhe personat me aftësi të kufizuara, trajtohen me përparësi, në lidhje me subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit. Sipas këtij ligji, familjet romë pa të ardhura dhe personat me aftësi të kufizuara (në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave) mund të përfshihen vetëm në programin social të strehimit për subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit.

Referuar shkresës nr. 3814/1, datë 04.09.2017 të dërguar nga Bashkia Korçë dhe Kërkesës datë 10.10.2017 të dërguar nga subjekti ankues, në të cilën informohet se është arritur marrëveshja për strehimin e A.L nga ana e bashkisë Korçë, Komisioneri vlerëson se u arrit qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të strehimit të A.L.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e çështjes për A.L, pasi u arrit dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI